



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

RELACION

Lezhë me 19.02.2024

**Drejtuar: Këshillit Bashkiak
Të nderuar Këshilltarë!**

Njësia e Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë vlerëson si të rëndësishme mundësinë potenciale për shfrytëzimin e aseteve pyje dhe kullota për alternativa të ndryshme përdorimi, me fokus zhvillimin e biznesit nga kompani të ndryshme të interesuara. Dhënia në përdorim e sipërfaqeve pyjore duhet parë si një interes financiar i Bashkisë pasi nga kryerja e këtyre transaksioneve gjenerohen të ardhura duke i përkthyer në investime për administrimin dhe ruajtjen e fondit pyjor e kulloror Bashkiak. Sipas dokumentacionit të hartuar nga Njësia e Administrimit të Pyjeve sipërfaqja e marrë në studim dhe që ju propozohet të jepet në përdorim sipas procedurave të prokurimit publik me garë të hapur, është studiuar nga kompania **AYEN RENEËABLE ENERGY** e cila ka nxjerrë rezultatet e erës dhe nëpërmjet një kërkesë i është drejtuar Bashkisë Lezhë për ta marrë në përdorim sipas procedurave që kërkon ligji. Pasi është përcaktuar sipërfaqja pyjore ku mund të vendosen aerogjeneratorët, është hartuar raporti tekniko-ekonomik për sipërfaqen pyjore që do të preket nga projekti fitues, gjithashtu është nxjerrë edhe vlera financiare e përdorimit të sipërfaqes pyjore dhe të infrastrukturës ndihmëse.

Baza ligjore:

Ligji nr.139 datë 17.12.2015"Për Vetëqeverisjen vendore".

Ligji nr.8480,datë27.05.1999"Përfunksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

Ligji nr. 107/2014 datë31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Ligji nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet".

VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre".

VKM-në nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".

Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".
Udhëzimit Nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit Mjedisit, "Përmbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar".

Duke pritur miratimin tuaj ju falenderojmë për mirëkuptimin!

Hartoi relacionin

Përgjegjësi i Njesisë së Administrimit të Pyjeve

Artan PALUSHI

